

Nr.146/24

Në mbështetje të nenit 6, 7, 8 dhe nenit 9 të Rregullores Disiplinore të Federatës së Volejbollit të Kosovës (FVK), Komisioni Disiplinor i FVK-së, pas zhvillimit të procedurës disiplinore mori këtë

V E N D I M

- I. Klubi i Volejbollit (KV) “Peja”, për shkelje të rëndë disiplinore, denohet me gjobë në lartësi prej 2,000 € (dymijë euro).
- II. Arlind Kabashi (nr. 7), lojtar i KV “Peja”, për shkelje të rëndë disiplinore, i shqiptohet masa disiplinore: “Ndalimi i pjesëmarrjes në gara në afat prej 10 vitesh, si dhe denohet me gjobë në lartësi prej 1,000 € (njëmijë euro)”.
- III. Leutrim Mujaj (Nr.1), lojtar i KV “Peja”, për shkelje të rëndë disiplinore, i shqiptohet masa disiplinore: “Ndalimi i pjesëmarrjes në gara në afat prej 10 vitesh, si dhe denohet me gjobë në lartësi prej 1,000 € (njëmijë euro)”.
- IV. Agron Nikçi, (Nr. 10), lojtar i KV “Peja”, për shkelje të rëndë disiplinore, i shqiptohet masa disiplinore: “Ndalimi i pjesëmarrjes në gara në afat prej 3 vitesh, si dhe denohet me gjobë në lartësi prej 800 € (tetëqind euro)”.
- V. Kaltrim Berisha (Nr. 2), lojtar i KV “Peja”, për shkelje të rëndë disiplinore, i shqiptohet masa disiplinore: “Ndalimi i pjesëmarrjes në gara në afat prej 3 vitesh, si dhe denohet me gjobë në lartësi prej 600 € (gjashtëqind euro)”.
- VI. Dardan Husaj (Nr. 18), lojtar i KV “Peja”, për shkelje të rëndë disiplinore, i shqiptohet masa disiplinore: “Ndalimi i pjesëmarrjes në gara në afat prej 3 vitesh, si dhe denohet me gjobë në lartësi prej 600 € (gjashtëqind euro)”.
- VII. Gazmend Husaj (Nr. 8), lojtar i KV “Peja”, për shkelje të rëndë disiplinore, i shqiptohet masa disiplinore: “Ndalimi i pjesëmarrjes në gara në afat prej 1 viti, si dhe denohet me gjobë në lartësi prej 500 € (pesëqind euro)”.
- VIII. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Komisioni Disiplinor (këtu e tutje Komisioni) në formë elektronike, më datën 03.12.2024, ka pranuar njoftim nga sekretari i përgjithshëm i FVK-së, z. Valon Nikçi, në të cilin ka gjetur të bashkëngjitur Vendimin e z. Ardian Ibraj, komesar i FVK-së, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj lojtarëve të KV “Peja”, fillimisht ndaj lojtarëve Arlind Kabashi (lojtari me numër 7) dhe Leotrim Mujaj (lojtari me numër 1) dhe Agron Nikçi (lojtari me numër 10), përderisa pas analizimit të video-incizimeve të incidentit në fjalë, procedurë e njëjtë është iniciuar edhe për Kaltrim Berisha (lojtari me numër 2), Dardan Husaj (lojtari me numër 18) dhe ndaj Gazmend Husaj (lojtari me numër 8), nën arsyetimin se pas përfundimit të ndeshjes finale të “Kupa e Federatës” më mes të KV “Ferizaj” – KV “Peja”, e zhvilluar me datën 01.12.2024, me fillim në ora 20:15, në Palestrën “Bill Kllinton” në Ferizaj, të njëjtit janë përfshirë në rrahje dhe incidente me tifozët vendas, gjegjësisht atyre të KV “Ferizaj”.

Ashtu siç përcaktohet me aktet në fuqi, Komisioni, më qëllim që menjëherë të filloj me shqyrtimin e fakteve dhe të provave në procedurën disiplinore, me datën 04.12.2024, në orën 18.00, në lokalet e FVK-së, ka mbajtur takimin e parë shqyrtues, me ç’rast ka dizajnuar administrimin e procesit për të vlerësuar faktet dhe rrethanat e ngjarjes që janë të nevojshme për marrjen e vendimit.

Në kuadër të këtij takimi, Komisioni, në përbërje të plotë, 1. Fidan Hamiti, kryetar, 2. Liridon Dalipi, anëtar dhe 3. Gani Beqiri, anëtar, me aprovim unanim, vendosi që për qëllime të verifikimit të fakteve dhe në zbatim të drejtë të Rregullores Disiplinore të FVK-së, duke zbatuar nenin 4 të Rregullores Disiplinore, nëpërmjet shërbimeve të sekretarisë të FVK-së, për t’u njohur me variantin e ngjarjes apo të problemit, lojtarëve të përfshirë në konflikt dhe KV “Peja” t’u kërkohet që të deklarohen më shkrim.

Në funksion të trajtimit të lëndës, përveç takimit të datës 04.12.2024, Komisioni është takuar (në formë elektronike) edhe më datën 05.04.2024, 10.12.2024 dhe me datën 13.12.2024 (në formë elektronike). Në takime kanë qenë prezent: 1. Fidan Hamiti – kryetar, 2. Liridon Dalipi – anëtar, 3. Gani Beqiri – anëtar, si dhe në për qëllime të ofrimit të shërbimeve të sekretarisë, prezent kanë qenë edhe z. Valon Nikçi, sekretar i përgjithshëm i FVK-së.

Komisioni, brenda afatit të paraparë, nëpërmjet email-it, nga shërbimet e sekretarisë të FVK-së, sipas kërkesës, nga delegati i ndeshjes (sipas detyrës zyrtare), lojtarët e përfshirë dhe KV “Peja” ka pranuar deklarata të ndara për qëllime të paraqitjes së variantit të tyre të ngjarjes, në lidhje me incidentin në fjalë. Ndër të tjera, Komisioni ka pranuar edhe video-incizime amatore të ngjarjes me anë të të cilave është paraqitur pjesa nga fillimi i incidentit, eskalimi dhe realizimi i ngjarjes së ndodhur në kuadër të ndeshjes përkatëse.

Përveç provave shkresore, nga shërbimet e sekretarisë, në Komision është deponuar edhe video-incizimi i cili e ka të regjistruar komplet pjesën e incidentit në fjalë. Komisioni ka

pranuar edhe video-incizime të cilat kanë kapur momentet e ngjarjes nga perspektiva të ndryshme dhe të cilat kanë qarkulluar edhe në medie të ndryshme dhe rrjete sociale.

Komisioni për shkak të natyrës së njëjtë të shkeljeve disiplinore të supozuara ka bashkuar lëndën dhe të njëjtën e ka trajtuar si tërësi.

Komisioni disiplinor pas vërtetimit të drejt të gjendjes faktike dhe juridike dhe duke u mbështetur në provat në dispozicion, konstatoi:

Nga video-incizimet e deponuara (të cilat kanë qarkulluar edhe në rrjete sociale) shihet qartë se si lojtarët e KV “Peja” lëshojnë parketin duke vrapuar në mënyrë të nxituar, drejt një turme të tifozëve të ekipës vëndase, ku më të arritur të njëjtit përfshihen në konfrontime fizike. Në bazë të video-incimeve përkatëse konstatohet se ka pasur shtyrje, goditje dhe kapje në mënyrë agresive të të gjithë të përfshirëve.

Në kuptim të komisionit disiplinor, përshkrimi i situatës së lojtarëve dhe klubit nëpërmjet deklaratave të deponuara (të cilat esencialisht janë të njëjta) nuk përkojnë me realitetin e pasqyruar në video-incizimet me të cilat ka disponuar Komisioni gjatë administrimit të provave. Megjithëse të njëjtit kanë mundur të jenë të provokuar, siç edhe konfirmohet me raportin zyrtar të delegatit të ndeshjes z. Lulzim Gërguri, kjo nuk e justifikon faktin e sjelljes së tyre.

Për Komisionin, KV “Peja” dhe zyrtarët e klubit nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim për t’i trajtuar sjelljet e lojtarëve të përfshirë, gjë e cila bie ndesh me parimet që promovon loja e volejbollit dhe sporti në përgjithësi. Injorimi i asaj që ka ndodhur, nga KV “Peja”, jo vetëm që dëmton sportin por gjithashtu rrezikon dhe dëmton edhe të ardhmen e vet klubit.

Për Komisionin, lojtarët e përfshirë por edhe sportistët në përgjithësi pritet të ngrihen mbi provokimet dhe të qëndrojnë të qetë edhe përballë sfidave. Dhuna e shpërfaqur jo vetëm që dëmton karrierën e tyre, por gjithashtu minon vlerat e respektit, disiplinës dhe unitetit që sporti synon ta promovojë. Në situata të tilla, lojtarët duhet të kanalizojnë frustrimet në mënyrë konstruktive dhe të mbështeten te personeli ose autoritetet e sigurisë për të trajtuar çdo provokim të publikut. Për me tepër, edhe në situata provokues dhuna në sport, qoftë në fushë apo jashtë, shembë vlerat e asaj se çka i njëjt promovom. Pra, thelbi i sportit qëndron te respekti, disiplina dhe ndjekja e përsosmërisë dhe jo në agresion apo konflikt.

Ndërlidhur më frymën e Rregullores Disiplinore e cila promovon faktin se dënimet kanë karakter edukues, parandalues dhe korigjues, dhe shqiptimi i tyre do të ketë gjithmonë qëllimin e mbrojtjes së interesit të përgjithshëm dhe vlerave të sportit të volejbollit, Komisioni ka marrë për bazë edhe rrethanat lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet me një dënim më të butë dhe rrjedhimisht ka marrë në konsideratë shqiptimin e një dënimi më të ulët se ai i paraparë me Rregulloren përkatëse, veçanërisht kur në rastin konkret kemi të bëjmë me individ që kanë merita për zhvillimin e sportit të volejbollit. Komisioni, në matje të dënimit ka marrë për bazë rrethanat lehtësuese dhe ato ndikuese të cilat lidhën më rrethanat, në të cilat është kryer shkelja, sjellja e të përmendurve para dhe pas shkeljes, vetitë morale dhe qëndrimi i tyre pas veprimit të bërë.

Andaj, pas shqyrtimit të deklaratave të lojtarëve, deklaratës së KV “Peja”, deklaratës së delegatit të ndeshjes, video-incizimeve përkatëse dhe dokumenteve të tjera relevante, të cilat janë pjesë e dosjes së lëndës, Komisioni ka gjetur prova të mjaftueshme të cilat e konfirmojnë faktin se lojtarët dhe klubi kanë konsumuar shkelje të natyrës së rëndë disiplinore, që bien ndesh me Rregulloren për Procedurë Disiplinore dhe rrjedhimisht vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


KOMISIONI DISIPLINOR :



Gani Beqiri, anëtar



Fidan Hamiti, kryetar



Liridon Dalipi, anëtar

Prishtinë, 14.12.2024

Vendimi t’u dërgohet:

- KV “Peja”,
- Të përmendurëve,
- Anëtarëve të FVK-së,
- Anëtarëve të Komisionit Disiplinor të FVK-së dhe
- Arkivit të FVK-së.

**KËSHILLË
JURIDIKE:**

Konform Nenit 12 paragrafi 12.1 të Rregullores Disiplinore, kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të shkallës së parë mund të parashtrohet ankesë në Komisionin e Ankesave në afat prej 15 ditësh, kundrejt pagesës prej 300 euro.